



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

# Raporti i vetë-vlerësimit

Ky raport ngërthen periudhën 1 shtator 2013 - 31 gusht  
2014

UEJL Tetovë, Nëntor 2014

## Përmbajtja

---

1	Hyrje.....	1
2	Të arriturat.....	3
3	Struktura: fakultetet dhe qendrat .....	4
3.1	Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë.....	5
3.2	Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore .....	5
3.3	Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit .....	6
3.4	Fakulteti i Drejtësisë.....	7
3.5	Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike.....	8
3.6	Qendra e gjuhëve .....	8
3.7	Qendra për e-Mësim .....	9
4	Sigurimi i cilësisë .....	10
5	Mësimdhënia dhe të nxënit .....	11
5.1	Programet dhe statusi.....	11
5.2	Regjistrimi i studentëve.....	12
5.3	Kalueshmëria e studentëve.....	13
5.4	Diplomimi i studentëve .....	13
5.5	Qendra e karrierës dhe punësushmëria .....	14
5.6	Asociacioni Alumni .....	15
6	Hulumtimi .....	15
6.1	Instituti i hulumtimeve “Max Van der Stoel” .....	16
6.2	Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit.....	17
6.3	Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare .....	17
7	Ndërmarrësia dhe zhvillimi .....	18
8	Financimi.....	19
9	Mjedisi dhe shërbimet në kampus .....	20
9.1	Përkrahja studentore .....	20
9.2	Ngrëhinat dhe kapacitetet teknike .....	21
9.3	Qendra e UEJL-së në Shkup.....	21
9.4	Burimet njerëzore .....	23
9.5	Sistemet e informacionit .....	24
9.6	Biblioteka.....	25
9.7	Parlamenti i studentëve .....	26
9.8	Sporti dhe rekreacioni.....	26
10	Konkluzionet .....	28
	Anëtarët e komisionit të vetë-vlerësimit.....	29



# 1 Hyrje

---

Ky raport i vetëvlerësimit mbulon periudhën nga 1 shtatori 2013 deri në 31 gusht 2014. Gjatë kësaj periudhe, Universiteti ka shënuar dymbëdhjetëvjetorin e themelimit. Universiteti ruan pozitën e vet në mesin e tri institucioneve kryesore të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë, sipas renditjes së Universitetit të Shangait "Jio Tong" dhe është i vetmi ndër institucionet që janë në majat e kësaj renditjeje, e që nuk është universitet shtetëror.

Në kuadër të Universitetit, veprojnë pesë fakultete në dy lokacione. Kampusi kryesor i vendosur në bazën origjinale të universitetit në Tetovë dhe kampusi shtesë që vepron në kryeqytet-Shkup. Pesë fakultetet përbërëse të Universitetit janë: Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë; Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore; Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit; Fakulteti i Drejtësisë; dhe Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike. Të pesë fakultetet ofrojnë programe në të tri ciklet e studimit të arsimit të lartë (deridiplomike, pasdiplomike dhe studimet e doktoratës). Shkolla e doktoratës filloi me punë dhe studentët e doktoratës kanë filluar me kohë aktivitetet studimore gjatë kësaj periudhe. Programi "studimet e integruara", i bazuar në modelin e suksesshëm gjerman, duke kombinuar të mësuarit në klasë me praktikën dhe i njëjti është përfshirë në këtë raport; ky program është mbështetur bujarisht nga Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit.

UEJL vazhdon të përballet një situatë të përcjellë me vështirësi të vazhdueshme në rajon dhe në vend. Situata sfiduese financiare dhe arsimore në Republikën e Maqedonisë, mund të jetë e pafavorshme për rekrutimin e studentëve. Ekonomitë në rajonin e Ballkanit mbetën të ngadalta dhe të ngathëta. Procesi i disperzimit të arsimit në fshatra dhe qytete më të vogla dhe i sponsorizuar nga shteti ka rritur konkurrencën për regjistrimin e studentëve, por nuk ka arritur ta përmirësojë dukshëm ofertën akademike në dispozicion të atyre studentëve. Numri i zvogëluar i lindjeve dhe emigracioni kanë ulur numrin e regjistrimeve të studentëve të mundshëm për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në vend. Investimi i shtetit në burimet akademike, mbështetja e hulumtimit, si dhe sigurimi i granteve dhe bursave mbetet i pamjaftueshëm për të ndërtuar një kulturë thelbësore akademike në nivel shtetëror.

Edhe përkundër këtyre vështirësive, është e rëndësishme të theksohet se gjatë periudhës së përfshirë në këtë raport, regjistrimi i studentëve në Universitetin e Evropës Juglindore u rrit, duke përmbysur një tendencë të disa viteve të mëparshme. Ky ishte një lajm i mirëpritur për stafin, studentët dhe menaxhmentin e Universitetit, gjë që përkon me vlerat e qëndrueshme të përcaktimit të deklaruar të UEJL për cilësi në mësimdhënie, hulumtim dhe mbështetje të studentëve.

Në përputhje me këtë, angazhimi për cilësi gjatë vitit të kaluar ka qenë historikisht dhe mbetet një nga zhvillimet më të rëndësishme të UEJL, si institucion: rimodelimi, hapja dhe funksionimi i klasave në kampusin e ri të Shkupit. Kjo ndërtesë, e vendosur në mënyrë simbolike në një urë që lidhë pjesët tradicionale shqiptare dhe maqedonase të kryeqytetit, është dëshmuar të jetë një vend efektiv, tërheqës dhe i shquar për Universitetin e Evropës Juglindore për të funksionuar në Shkup. Si pjesë e angazhimit të Universitetit për kujdesin ndaj mjedisit, ndërtesa u rinovua brenda për të përmbushur kërkesat e institucionit. Struktura ekzistuese u ridestinua, duke kursyer harxhime të konsiderueshme materiale që do të kishin rezultuar nga ndërtimi i një ndërtese krejtësisht të re. Në Tetovë, është bërë punë substanciale për të ndërruar strukturën e sistemit të ngrohjes së Universitetit me naftë me teknologjinë e ripërtërishme të biomasës.

Shumë prej mekanizmave të sigurimit të cilësisë që zbaton UEJL kanë vazhduar gjatë periudhës së mbuluar nga ky rishikim. Për stafin akademik, përsëri ka vazhduar procesi i "vëzhgimit të mësimdhënies", ku të gjithë mësimdhënësit janë vëzhguar nga kolegët të paktën për orë mësimore gjatë vitit akademik dhe ku është siguruar informatë kthyesë, mbështetje, përgëzime për praktikën e mirë, si dhe sugjerime për përmirësim. Këto vëzhgime janë bërë në dy forma: vëzhgime të lajmëruara dhe të paparalajmëruara. Ngjashëm, të gjithë anëtarët e stafit janë vlerësuar nga menaxheri i tyre i linjës për kryerjen e punëve dhe negociimin e objektivave për vitin e ardhshëm. Opinioni i studentëve është marrë për të gjithë mësimdhënësit me anë të pyetësorëve anonimë. Mbi njëqind studentë kanë marrë bursa, në bazë të meritës apo nevojës financiare. Studentëve u është dhënë mundësia që të zvogëlojnë pagesën e shkollimit nëpërmjet programit {punë dhe studime". Qendra e karrierës ka ofruar përkrahje të mëtijshme të punësimit: Qendra e karrierës ka ndihmuar në organizimin e punës praktike për studentët, ka ofruar trajnim për teknikat e intervistimit dhe të shkruarit e CV, pastaj ka organizuar dhe ka mbajtur edhe Panairin e karrierës së UEJL. Qendra e gjuhëve ka vazhduar të ofrojë lëndët gjuhësore në të tri gjuhët në nivel të Universitetit, me qëllim të avancimit të përkushtimit të Universitetit për politikën e "përdorimit fleksibil të gjuhëve".

Universiteti, gjithashtu ka vazhduar qasjen e administrimit të mjedisit. Përveç përshtatjes së ndërtesës "MOST" në Shkup, Universiteti ka investuar fonde të konsiderueshme për riparimin e tubacioneve të naftës. Kjo, bëri që UEJL të vendosë sistemin ngrohjes së përshtatshme ekologjikisht me biomasë. Gjithashtu, Universiteti ka kontraktuar një ofertues të ri, i cili ka bërë një investim të konsiderueshëm për ripërshtatjen e kafiterisë të Universitetit.

Kështu, pavarësisht sfidave të paraqitura nga politikat kombëtare dhe ndërkombëtare të konkurrencës në arsimin e lartë, Universiteti i Evropës Juglindore vazhdon të jetë një ofrues i respektuar arsimor me cilësi të lartë në Ballkanin Jugor. Institucioni ynë vazhdon t'i mbetet besnik vizionit të themeluesve të vet: përmes UEJL-së, arsimit të lartë vazhdon të jetë në dispozicion të studentëve, pavarësisht gjuhës, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë, apo përkatësisë politike.

## 2 Të arriturat

---

Gjatë vitit akademik 2013-2014, Universiteti ka plotësuar disa zhvillime të përmendura më parë në Raportin e vetëvlerësimit si aktivitete të planifikuara. Siç është konstatuar më lart, Universiteti filloi me funksionimin e Shkollës së doktoratës, që ka tërhequr kandidatë nga Maqedonia dhe nga jashtë dhe që është akredituar plotësisht në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë. Në mënyrë të ngjashme, mësime të reja të planifikuara të jenë mentorë të kandidatëve doktorantë kaluan nëpër një proces të akreditimit qeveritar. Në këtë mënyrë është e qartë se studentët e doktoratës së UEJL-së janë duke studiuar në një program që është vlerësuar në mënyrë efektive dhe i miratuar dy herë nga ana e autoriteteve shtetërore. Kjo i jep të drejtën UEJL-së të mbajë mësime të reja dhe të japë diploma në të tri ciklet e arsimit të lartë. Në mënyrë të ngjashme, programi Studimet e integruara filloi të funksionojë, nën drejtimin individual të ekspertit të caktuar nga Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit, Prof. Norbert Marx.

Ndoshta, e një rëndësie më të madhe për Universitetin të Evropës Juglindore ishte hapja formale dhe lëshimi në përdorim i objektit të ri në Shkup. Kjo ndërtesë ofron mjaft hapësira për mësime të reja dhe për pozitave administrative krahasuar me vendin e mëparshëm në Shkup, pasi ndërtesa u rinovua me specifikimet e UEJL-së. Në këto lokale të reja, të veçanta dhe në qendër, përveç klasave dhe zyrave ka - dy laboratorë kompjuterikë, ka degën e bibliotekës "Maks van der Shtul", hapësirat rekreative për studentët, pastaj një amfiteatër me afro 100 ulëse dhe një terracë me pamje nga qyteti për pritje formale të mysafirëve të shquar.

Lidershipi rajonal i Universitetit në lëmin e mjedisit u njoh më 20 shtator 2013, kur UEJL nënshkroi marrëveshje me Komunën e Tetovës për të ndihmuar komunën në përpilimin e 'Planveprimet klimatike të qytetit të Tetovës'. Në mënyrë të ngjashme, puna ka vazhduar në kampusin e Tetovës, ku është punuar në ndryshimin e sistemit të ngrohjes së Universitetit nga ai më naftë në sistem ekologjik më të përshtatshëm, pra ku si lëndë djegëse përdoret biomasa.

UEJL ka mbajtur profil të lartë të centralitetit akademik në nivel lokal dhe rajonal. Universiteti mbetet i përkushtuar për shkëmbimin e njohurive në publik dhe shprehjes së përgjegjshme dhe me respekt të opinioneve të ndryshme. Në përputhje me rrethanat, UEJL ishte nikoqir i disa konferencave gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, duke mbuluar tema të ndryshme nga sociolinguistika, perspektivat e bashkëpunimit 'Beneluxi Ballkanik', Lufta e parë botërore, Shumëgjuhësia dhe politikat gjuhësore, Cilësia në arsim dhe të shkruarit kreativ. Nën iniciativën e Institutit Maks van der Shtul, ambasadorë të shumë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare (duke përfshirë edhe ata të Holandës, Gjermanisë, Francës dhe OSBE-së), iu drejtuan studentëve dhe stafit në MVDSRI 'Seria e ligjëratave diplomatike. "Universiteti vazhdoi të sigurojë mbështetje të gjerë për stafin akademik për të marrë pjesë në konferenca dhe për të botuar punimet e tyre.

Universiteti ka ruajtur përkushtimin e tij ndaj politikave të sigurimit të cilësisë, procedurave, dhe trajnimit. Në të dy sesionet e trajnimit në janar dhe në gusht 2014, i gjithë personeli akademik dhe administrativ i UEJL-së ka ndjekur trajnimet shumë-ditore, në mënyrë që të mësohen qasje të reja dhe të shkëmbehen përvojat për zgjidhjen e sfidave të përbashkëta. UEJL, gjithashtu priti një ekip të ri dy anëtarësh të kampionëve të cilësisë nga Mbretëria e Bashkuar, Francis Owens dhe Steven Bristow, të cilët janë ekspertë të dalluar në vlerësimin akademik. Universiteti, ka filluar edhe procesin e rishikimeve të veçanta të jashtme të fakulteteve, procedurë kjo që përfshihet në këtë raport, e që do të vazhdojë vitin e ardhshëm.

UEJL, po ashtu ka mbetur i përkushtuar për përmirësimin social dhe personal të stafit dhe studentëve. Universiteti ka ofruar disa mundësi për aktivitete sportive, duke filluar nga marshet në Malin Sharr, garat vjetore interuniversitare me karakter konkurrues në skitari dhe kampionatin në futsall (ku fitues ishte ekipi i UEJL-së). Në kuadër të 'ligjëratave diplomatike', diplomatë të mirënjohur kanë mbajtur ligjërata në Universitet për studentët dhe stafin. Universiteti ishte organizator i "Ditës së Mandelës", ku studentët dhe stafi kanë bashkëpunuar për të mësuar në lidhje me z. Mandelën dhe për të reflektuar mbi kuptimin e lirisë. UEJL vazhdon të ofrojë kurse për zotimin e gjuhëve, por kishte kurse modulare mjaft 'interesante', si kursi Pranvera 2014 për artin 'Ebru' (teknika artistike e ngjyrosjes në mermer).

Megjithatë, rritja e numrit të studentëve të regjistruar është, ndoshta arritja më e rëndësishme e periudhës së përfshirë nga ky raport. Në një kohë të zgjerimit të konkurrencës, subvencionimit të qeverisë për tarifat e shkollimit në institucionet tjera dhe rënia demografike e numrave të studentëve në dispozicion për t'u regjistruar, rritja e numrit të studentëve të regjistruar në UEJL është konfirmimin inkurajues për përkushtimin e UEJL-së për cilësinë, ndërkombëtarizimin dhe multikulturalizmin që përputhet me shpresat arsimore dhe pritjet e popullit të rajonit.

### 3 Struktura: fakultetet dhe qendrat

---

Universiteti i Evropës Juglindore operon me dy kampuse universitare në Tetovë dhe në Shkup. Struktura e universitetit përbëhet nga pesë fakultetet: Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë; Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore; Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit; Fakulteti i Drejtësisë; dhe Fakulteti Administrimit Publik dhe Shkencave Politike. Mësimdhënia e gjuhëve (ofrohet nga Qendra e gjuhëve), shkathtësitë e TI (ofrohen nga Qendra për eMësim) dhe lëndët 'zgjedhore të lira' (ofrohen për të gjitha disiplinat), studentët kryesisht studiojnë në fakultetin e zgjedhur në fillim. Hulumtimi ndërmerret nga studentët dhe stafi në mënyrë individuale; hulumtimi kolektiv shpesh ndërmerret në marrëveshje me fakultetin, ose në kuadër të Institutit të hulumtimit (Max van der Stoel Research dhe Institutit të mjedisit dhe shëndetit) dhe Zyrës për hulumtim.

### 3.1 Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë mbetet fakulteti i vetëm më i madh në nivel të Universitetit dhe vazhdon të ofrojë programe mjaft atraktive në të gjithë tri ciklet. Veçanërisht është i famshëm programi i biznesit dhe ekonomisë në ciklin e parë.

Gjatë periudhës së mbuluar nga raport, Fakulteti realizoi vlerësimin e jashtëm të programeve nga Universiteti i Indianaës, SHBA, Prof. Munirpallam Venkataramanan. Ai bëri rishikimin e plotë të programeve të Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë dhe dorëzoi një raport mjaft të detajuar, duke dhënë sugjerimet dhe iniciativat e tij profesionale. Fakulteti planifikon t'i implementojë këto sugjerime programore gjatë vitit të ardhshëm, në kontekst të sigurimit të cilësisë dhe mundësisë për rritjen e programeve në bashkëpunim me Kelley School of Business nga Bloomington.

Nga të dhënat e regjistrimit të studentëve, del se programi i Biznesit dhe Ekonomisë mbetet programi më atraktiv në nivel të fakultetit. Regjistrimi i studentëve në studimet e magjistraturës dhe doktoraturës është mjaft inkurajues.

Fakulteti nga afër ka bashkëpunuar me bizneset lokale dhe stakeholderët e jashtëm, nga komuniteti financiar dhe ndërmarrës. Në bashkëpunim me QZHB dhe Parkun teknologjik, fakulteti kërkon të udhëheq integrimin e akademisë me stakeholderët financiar dhe ata të biznesit.

### 3.2 Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore vazhdon të ofrojë arsimim me cilësi të lartë në disa nga fushat më të avancuara të përpjekjeve shkencore. Qëllimi i FSHTB është të mbetet lider rajonal në informatikë dhe në shkencat kompjuterike pasi kompjuterët dhe programimi gjithnjë bëhen më të integruar në jetën tonë, kurse shkathtësitë dhe aftësitë e ligjëruara në programet studimore të SHTB mbeten shumë konkurruese në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.

Tre përfaqësues të fakultetit vizituan Gjøvik College University, në Norvegji, të lidhin partneritet për hulumtim në të ardhmen dhe për të promovuar mobilitetin e stafit. Përveç kësaj, SHTB inkurajon dhe mbështet studentët e vet për të marrë pjesë në programet e mobilitetit; vetëm vitin e kaluar SHTB kishte pesë mundësi të tilla të këmbimit për studentët e vet.

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar promovimin e tij në rajon dhe është angazhuar në përpjekjet e shumta promovuese dhe të rekrutimit në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. SHTB gjithashtu e ka mbështetur pjesëmarrjen e stafit në konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta, për të rritur njohuritë e tyre dhe për të ndërtuar kontakte profesionale. Fakulteti ka ruajtur "grupet hulumtuese" që u themeluan në vitin e kaluar. Brenda "grupeve hulumtuese", një numër i projekteve hulumtuese u dorëzuan për mbështetje financiare të jashtme kur një projekt fitoi financim. Fakulteti



vazhdon të mbështesë stafin që pjesëtarët e tij të shkruajnë propozime të kërkimit shkencor me qëllim kryesor të gjetjes së fondeve të jashtme, si dhe rritjen e transparencës së fakultetit, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Fakulteti është vlerësuar nga një vlerësues i jashtëm, Prof. Mathew Palakal, Universiteti i Indianës- Universiteti Purdue Indianapolis-, përpjekjet e tij për të ndihmuar në ristrukturimin e kurrikulave u pranuan pozitivisht nga menaxhmenti dhe stafi SHTB në përgjithësi. Fakulteti ka organizuar një seminar mbi harmonizimin e kurrikulave në Durrës, Shqipëri, ku një diskutim i rëndësishëm është bërë lidhur me atë që është ofruar dhe atë që është e nevojshme për t'u ndërmarrë, duke rezultuar në disa projektpropozime për ndryshime të kurrikulave për programet ekzistuese.

Si objektiva për të ardhmen, fakulteti kërkon të vazhdojë të ndërtojë lidhje të forta me grupet e interesit profesional; për të ruajtur punësimin e mirë të të diplomuarve; dhe për të promovuar të mësuarit e bazuar në kompetenca në të gjitha ciklet.

### 3.3 Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit ka ofruar programe studimore në disiplinat e mëposhtme: Gjuhë dhe letërsi shqipe; Gjuhë dhe letërsi angleze; Gjuhë dhe letërsi gjermane dhe Komunikim ndërkombëtar. Fakulteti ofron mësimdhënie në shkathtësitë gjuhësore, pedagogji, komunikim dhe përkthim, për studentët nga cikli i parë, i dytë dhe i tretë (doktoratës) i studimeve.

Departamenti i Gjuhës angleze kishte një vit të mirë. Numri i studentëve të parë që u regjistruan në studimet e ciklit të tretë (Shkollën e doktoratës së UEJL) ishte 5 studentë. Numri i studentëve të regjistruar në studimet e ciklit të dytë u rrit përsëri me 40 studentë të rinj të regjistruar në programin e magistraturës - mësimdhënia e gjuhës angleze. Në studimet e ciklit të parë, u hap një grup i ri në kampusin e Shkupit dhe regjistrimet në kampusin në Tetovë ishte dukshëm i lartë deri në vitin e kaluar. Departamenti e ka akredituar me sukses programin e ri të magistraturës përkthim dhe interpretim sipas modelit 60 dhe 120 ECTS; megjithatë, për arsye të numrit të ulët të regjistrimeve programi nuk u hap për vitin 2014-15. Mobiliteti i studentëve është rritur ndjeshëm për semestrin dimëror 2014 me 12 studentë që shkojnë nga Fakulteti GJKK dhe 8 marrëveshjeve të reja këmbimi Erasmus + janë iniciuar nga Fakulteti në gjuhën angleze, gjermane dhe Komunikim ndërkombëtar.

Departamenti i Gjuhës gjermane gjithashtu kishte një vit të mirë, me regjistrimet rreth year, me regjistrim të qëndrueshëm, në programet studimore në ciklin e parë dhe ciklin e dytë dhe rritje të dukshme për vitin akademik 2014-15. Departamenti ishte i përfshirë nga afër në një konferencë të organizuar së bashku në temë Autonomia e nxënies së gjuhëve e cila u mbajt në Tetovë më 29-30 nëntor 2013, në bashkëpunim me Universitetin e edukimit të mësuesve në Zug/Lucern, Zvicër. Departamenti krijoi një

partneritet të ri Erasmus me Pädagogische Hochschule, Heidelberg, dhe shkëmbimet e para studentore u zhvilluan në semestrin e dimëror 2014.

Departamenti i komunikimi vazhdoi t'i tërheqë studentët rinj për programin e ciklit të parë- Komunikimi ndërkombëtar. Shefi i Departamentit të komunikimit ishte shumë aktiv në përkrahjen e aktiviteteve hulumtuese të Fakultetit GJKK përmes drejtimit të tij të Institutit Max van der Stoel dhe me mbajtjen e një konferencë të suksesshme Sfidat bashkëkohore të multikulturalizmit dhe politikës gjuhësore, maj 2014. Anëtarët e Departamentit të komunikimit ishin nikoqirë gjatë një vizite të suksesshme studimore nga studentët e Fakultetit të komunikimit të Universitetit të Gallatasarajit, Turqi në prill 2014.

Departamenti Gjuhë dhe letërsi shqipe gjithashtu ka mirëpritur një brez të ri të studentëve të doktoratës, ku janë regjistruar 5 studentë për vitin 2013-14. Departamenti vazhdoi të udhëheqë shumë ngjarje kulturore dhe akademike, duke përfshirë një konferencë shumë të suksesshme në temë Gjendja dhe perspektiva e sociolinguistikës sot që u mbajt më 1 nëntor 2013, punimet e së cilës u botuan më pas në qershor 2014.

Iniciativat kryesore të fakultetit për vitin akademik 2013-14 ishin organizimi i konferencave dhe seminareve; rritja e mundësive për mobilitet, rritja e shkëmbimeve në Erasmus + dhe implementimi i programeve të reja të studimeve të doktoratës. Si fusha për punën në të ardhmen, fakulteti ka identifikuar rritjen e numrit të regjistrimeve të studentëve; rritjen e numrit të shkëmbimeve duke u bazuar në suksesin e deritanishëm për shkëmbimin në Erasmus në Fakultetin GJKK; përmirësimin e përkrahjes për studimet me korrespondencë nëpërmjet bashkërendimit më të mirë të këtyre moduleve dhe gjithashtu përmirësimin e bashkëpunimit me Qendrën e karrierës. Përveç kësaj, Fakulteti do të kërkojë për të zbatuar me sukses nismën e gjerë në universitetit, për të zhvilluar produktivitetin hulumtues dhe cilësinë në të gjitha katër departamentet.

### 3.4 Fakulteti i Drejtësisë

Fakulteti i Drejtësisë ofron studime në të gjitha tri ciklet me theks të veçantë në të Drejtën ndërkombëtare, të Drejtën civile dhe të Drejtën penale. Fakulteti është përkushtuar për mësimdhënie të cilësisë së lartë në tri ciklet. Mësimdhënia ofrohet nga përzjerja e stafit vendor akademik si dhe hulumtuesve dhe mësimdhënësve të rinj. Studentët mësojnë nga një shumëllojshmëri e metodologjive, duke përfshirë edhe një klasë që është projektuar për të replikuar një gjykatë.

Fakulteti i Drejtësisë vazhdon t'i japë prioritet hulumtimit të realizuar nga anëtarët e stafit. Stafi mësimdhënies i fakultetit, që të gjithë, kanë regjistruar hulumtimin në bazën e të dhënave për hulumtime të sapokrijuara të Universitetit dhe shumë prej tyre kanë prezantuar punimet e tyre në konferenca rajonale dhe vendore. Gjithashtu, një pikë krenarie për fakultetin është se ka pasur një rritje të ndjeshme në mbrojtjen e suksesshme të tezave të magistraturës nga studentët e ciklit të dytë të Fakultetit të drejtësisë. Cikli

i tretë, gjithashtu, paraqet një ofertë tërheqëse për studentët e drejtësisë dhe studentët janë pranuar në Fakultetin e drejtësisë, si studentët të doktoratës si në vitin 2013 dhe 2014.

Gjatë periudhës 5-9 maj 2014, studentët e Fakultetit të Drejtësisë vizituan Universitetin e Oksfordit, ku u njohën me historinë, organizimin, aktivitetet dhe sfidat e këtij universiteti të shquar. Në Londër, vizituan asociacionin Middle Temple, dhe Gjykatën Penale, me ç'rast studentët dhe stafi akademik ndoqën drejtpërsëdrejti disa seanca gjyqësore mbi disa çështje penale, ku kishin mundësi të njihen me mënyrën e udhëheqjes dhe organizimin e seancave gjyqësore, sipas sistemit juridik të Britanisë.

### 3.5 Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike

Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike ka vazhduar të ofrojë programe studimore në lëmin e Shkence politike, Marrëdhënieve ndërkombëtare dhe Shërbimet e administrimit publik dhe qeverisjes. Ofron studime në tri ciklet e studimit dhe në periudhën e mbuluar nga raport ka konstatuar rritje në numrin e studentëve të regjistruar.

Si pjesë e përkushtimit të Universitetit është bërë rishikimi i rregullt i programeve dhe kurrikulave, Fakulteti i AP&SHP ishte nikoqir i profesorit të dalluar Prof. Bojko Buçar në cilësinë e vlerësuesit të jashtëm, nga Universiteti i Lubjanës. Vlerësimi i tij pozitiv dhe përkrahës përmban një numër të rekomandimeve që fakulteti i planifikon ti implementojë në vitet që vijnë, si pjesë e tendencës në rritje të ndërkombëtarizimit të kontakteve akademike të fakultetit.

Ndërmjet zhvillimeve të dallueshme për fakultetin këtë vit ishte akreditimi i pranuar nga Asociacioni Evropian për Akreditim në Administratën Publike (EAPAA). Ky akreditim vin si njohje për përkushtimin e fakultetit për mësimdhënie të cilësisë së lartë në administrimin publik dhe fakulteti ka kënaqësinë të pranojë një njohje të tillë për respektim të standardeve ndërkombëtare në këtë lëmi.

Shumica e punës së realizuar këtë ka qenë në drejtim që të ruhet cilësia e ofertës akademike dhe të rritet kapaciteti hulumtues i stafit. Anëtarët e stafit të fakultetit kanë ndjekur disa konferenca shkencore dhe kanë prezantuar punimet hulumtuese të tyre; gjithashtu kanë publikuar punimet e tyre në revista shkencore rajonale dhe ndërkombëtare. Fakulteti në mënyrë të rregullt ka rishikuar zbatimin e ofertave akademike për mundësitë e punësimit për të diplomuarit e AP&SHP.

### 3.6 Qendra e gjuhëve

Qendra e gjuhëve (QGJ), ka vazhduar me praktikën e saj me cilësi të lartë të mësimdhënies dhe monitorimit të efektivitetit të programit përmes rishikimit dhe përshtatjeve të kurrikulave sipas të dhënave nga instrumente e cilësisë, të arriturave dhe testet për njohjen e gjuhëve në tri programet kryesore (anglisht, shqip dhe maqedonisht). Përveç provimeve të rregullta,

qendra ka administruar, analizuar dhe gjurmuar ecurinë e testeve për njohjen e gjuhëve, si dhe provimet me gojë në tri programet kryesore. Të dhënat e grumbulluara nga këto instrumente tregojnë përmirësim të qëndrueshëm të shkathtësive gjuhësore të studentëve si ata të vazhdojnë me kërkesat gjuhësore. Përsëri këtë vit akademik, mësimdhënësit e GJQ kanë arritur rezultatet më të larta mesatare se sa ato në nivel të Universitetit në të gjitha kategoritë në anketën Vlerësimi nga studentët.

Lëndët zgjedhore të lira të organizuara dhe të menaxhuara përmes Qendrës së gjuhëve kanë tërhequr shumë interes nga studentët dhe kjo konfirmohet me numrin e lartë të studentëve të regjistruar në këto lëndë. Kjo ofertë është e pasuruar me kursin e gjuhës italiane si gjuhë e huaj, e mbështetur nga Ambasada Italiane. Kurse Ambasada Franceze vazhdon të sponsorizojë dy kurse të gjuhës franceze.

Përveç rritjes dhe promovimit të programit të saj akademik, QGJ ka zgjeruar më tej ofertën për komunitetin, duke ofruar dy sesione të provimeve TOEFL ITP dhe disa kurse të gjuhës angleze për bankat dhe bizneset lokale në bashkëpunim me QZHB. Kontrata me Ambasadën e SHBA-ve për ofrimin e kurseve të gjuhës shqipe për stafin e saj është nënshkruar sërish për dy vitet e ardhshme.

QGJ ka kontribuar edhe në planin e Universitetit për marketing dhe promovim duke bashkë-organizuar garën kombëtar për Ese që tërhoqi më shumë se 400 pjesëmarrës nga i gjithë vendi dhe Panairin e gjuhëve për Ditën e hapur të Universitetit dhe të aktiviteteve të të mësuarit për të gjithë studentët në Javën e orientimit.

### 3.7 Qendra për e-Mësim

Aktivitet e Qendrës për e-Mësim në nivel të Universitetit mund të ndahen në tre segmente:

I pari është ofrimi i një vargu të lëndëve të shkathtësive të TI që ua japin studentëve shkathtësitë e nevojshme kompjuterike për karrierën e tyre të ardhshme. Lëndët zgjedhore të lira që ofrohen nga Qendra për e-Mësim mbulojnë një diversitet të temave me qëllim që të plotësojnë nivele të ndryshme të shkathtësive dhe interesit. Lëndët hyrëse si zakonisht ju ofrohen atyre studentëve që ju duhen njohje bazike, ndërsa lëndët e avancuara për aplikacionet e fundit ju ofrohen studentëve që kanë nevojë për shkathtësi më të sofistikuar dhe specializuara. Të gjitha këto lëndë ofrohen për stafin akademik dhe administrativ gjithashtu. Qëllimi është për të ofruar njohuri, shkathtësi dhe përvojë teknologjike që do të rris vlerën e çdo anëtari të stafit UEJL-së dhe në të njëjtën kohë të ndihmojë në zhvillimin profesional të tyre.

Segmenti i dytë i Qendrës për eMësim është që të mirëmbajë dhe monitorojë Sistemin për menaxhimin e të mësuarit (Learning Management System) – Libri. Për këtë stafi i Qendrës ofron mbështetje të vazhdueshme efikase për të gjithë stafin akademik për menaxhim të lëndëve të tyre në Libri. Në aspekt

të përmirësimit të cilësisë përmbajtjes së lëndës raporte të ndryshe mund të gjenerohen për çfarëdo lloji të aktivitetit në Libri.

Segmenti i tretë, Qendra për e-Mësim ofron mbështetje për studimet online. Me qëllim të përmirësimit të shërbimit për studentët dhe që të mbetemi konkurrent në aspektin ndërkombëtar, studimet online që filluan në vitin 2011 duhet të vazhdojnë të jenë një sferat kryesore për Qendrën për eMësim. Qendra për eMësim vazhdon të ofrojë sesione trajnimi për instrumentet dhe metodologjitë e mësimdhënies online. Numri i studentëve online rritet në UEJL. Kjo lëmi mund të identifikohet si sektor kyç për motivimin e stafit; shpresojmë të inkurajomë të gjithë stafin të rrisnin mësimdhënien, vlerësimin dhe ofrimin burimeve të tyre online.

Ndërmjet këtyre tre segmenteve të përgjegjësive, Qendra për eMësim bashkëpunon për të gjitha aktivitetet në nivel të Universitetit, ku kërkohet përvojë në TI.

## 4 Sigurimi i cilësisë

---

Në lidhje me sigurimin e cilësisë, aktivitetet mund të ndahet në dy seksione: përfshirjen dhe përdorimin e proceseve të jashtme, si dhe sistemet brendshme të cilësisë dhe kultura për cilësinë.

Në aspektin e jashtëm, Universiteti edhe njëherë ishte i ranguar lartë në vlerësimin kombëtar, duke u renditur i treti nga njëzet institucionet e vlerësuara. Në vlerësimin e parë UEJL u rangua i dyti. Ishte shumë e këndshme ndjenja që të konstatohet se të dhënat statistikore treguan përmirësim të qëndrueshëm, realist dhe objektiv. Si më parë, vlera e këtij hapi për Universitetin është se ne kemi ngulitur prioritetet e identifikuara në kriteret e rangimit lartë në strategjinë institucionale dhe planifikimit dhe ne vazhdojmë të punojmë aktivisht për zhvillimin e sferave të tilla: si rezultatet nga hulumtimi, rritjen e mobilitetit, cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies si dhe promovimit të stafit akademik.

Përveç kësaj, ka filluar një raund i dytë i rishikimeve të jashtme të programeve studimore, duke përdorur ekspertë ndërkombëtarë. Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, rishikimet jashtme janë përfunduar në fakultetin e BE, SHTB dhe GJKK/QGJ dhe rekomandimet e këtyre raporteve janë përfshirë në planet veprimet e fakulteteve përkatëse.

Në aspektin e strukturave të rregullta të cilësisë, Bordi i Universitetit ka siguruar monitorimin e rregullt të planeve të Universitetit dhe ka monitoruar zbatimin e të dhënave të verifikueshme të kontrollit të cilësisë në fushën e menaxhimit të performancës, auditimit financiar dhe planifikimit të Universitetit, vlerësimin e personelit dhe proceset punësimit, menaxhimit të performancës, pastaj të zhvillimit akademik. Komiteti për çështje të stafit dhe Komiteti për auditim dhe menaxhim të rrezikut shpesh ka mbikëqyrur mbledhjen dhe analizën e këtyre të dhënave.

Komiteti për çështje të stafit ka konstatuar dhe ka kontribuar kompletimin e rishikimit të Rregullores për rangim, rroga dhe kompensime të tjera, që do të konfirmohet nga Bordi në nëntor 2014. Është kompletuar rishikimi i rregulloreve dhe versionet përfundimtare, janë publikuar në ueb faqen e Universitetit. Universiteti përsëri është riçertifikuar me standardin e jashtëm ISO 9001:2008 për menaxhim të performancës. Gjithashtu, Raporti vjetor për rekrutim tregon se vendet e lira administrative janë plotësuar sipas një procesi të hapur dhe transparent, me çështjet e përshkruara për shqyrtim.

Politika e cilësisë lidhet direkt me Planin strategjik të Universitetit dhe Komisionit për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë të (KSMC), që ka siguruar një përshkrim të përgjithshëm dy herë brenda vitit. Vitin e kaluar, u rishikua sistemi i jashtëm kampionëve të cilësisë dhe UEJL priti dy kampionët e rinj të cilësisë të cilët bënë një vizitë të përbashkët në universitet dhe ofruan rekomandime shumë të dobishme me një fokus në fakultetet e BE dhe GJKK. Zyra cilësisë ka operuar dhe/ose mbështetur proceset kyçe të cilësisë të tilla si vëzhgimin mësimdhënies, anketën e vlerësimit nga studentët dhe procedurat e menaxhimit të performancës dhe ka shërbyer si koordinatore operacionale e aktivitetit. Zyra ka siguruar të dhëna kyçe për analizë për fakultetet/departamentet. Zyra gjithashtu ka dhënë mbështetje për Parlamentin studentor gjatë zgjedhjeve dhe në zhvillimin e aktiviteteve të saj. Ekipet e cilësisë ishin më funksionale në departamentet administrative për shkak të punës së kolegjiut, por ishin më pak të dukshme në fakultetet.

Në aspektin e sigurimit të cilësisë, disa zona kyçe për zhvillim në vitin e ardhshëm do të jenë: rishikimi i kompetencave të Zyrës së cilësisë dhe struktura institucionale e cilësisë; futja e një koncepti të ri për ekipet akademike të cilësisë; zhvillimi i strukturës institucionale i rishikuar, me një rishikim të plotë të PVP dhe rregulloreve; zbatimi i rekomandimeve, sipas nevojës, aty ku janë bërë nga auditorët e jashtëm; përfundimi i vizitës së dytë nga kampionët e cilinës (mars 2015) me fokus në fakultetet e mbetura; forcimi i aspektit bashkëpunues me planifikimin e veprimeve; forcimi i proceseve të rekrutimit të stafit akademik; dhe përfundimi i Sistemit të menaxhimit elektronik për të mbështetur analizën e të dhënave dhe cilësinë e proceseve të tilla si planifikimi.

## 5 Mësimdhënia dhe të nxënit

---

### 5.1 Programet dhe statusi

Të gjithë pesë fakultet e UEJL-së kanë ofruar programe studimore në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. Shkolla e doktoraturës ka operuar disa lëndë metodologjike në disa disiplina, duke mundësuar që studentët nga programe të ndryshme të studiojnë së bashku.

Me suksesin e Shkollës së doktoraturës dhe suksesin e vazhdueshëm të UEJL-së në ciklin e dytë të studimeve, është duke u bërë një kalim i dukshëm i trupit studentor; pasi numri i studentëve të regjistruar në ciklin e dytë rritet në

proporcion me studentët e ciklit të parë, UEJL ka rritur theksin në regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë dhe të tretë dhe përkrahje të hulumtimit.


## 5.2 Regjistrimi i studentëve

Është kënaqësi të konstatohet se ka rritje të numrit të studentëve të regjistruar për periudhën e mbuluar me këtë raport në krahasim me një vit më parë. Kjo është si rezultat kërkesës në rritje për ofertën studimore në ciklin e dytë në UEJL dhe hapjes së shkollës së doktoraturës.

Viti akademik	Numri i regjistrimeve
2011/2012	1280
2012/2013	1165
2013/2014	1257
<b>Gjithsejtë</b>	<b>3702</b>

Tabela 1. Numri i regjistrimeve të përgjithshme sipas vitit akademik

Të dhënat e regjistruara në Tabelën 1, tregojnë numrin e studentëve sipas gjuhës së studimit; siç mund të shihet, oferta studimore në gjuhën shqipe kryesisht ka ruajtur numrat e regjistrimeve, përderisa regjistrimet në gjuhën maqedonase kanë shënuar rënie dhe programet studimore në gjuhën angleze kanë shënuar rritje të dukshme.



Grafikoni 1. Numri i përgjithshëm i regjistrimeve

Tabela 2 Raporti për regjistrimet e përgjithshme sipas fakulteteve për tre vitet e fundit. Siç mund të shihet, tre fakultete kanë shënuar rritje në numrin e studentëve për periudhën e mbuluar me këtë raport, një fakultet ka ruajtur numrin e njëjtë të regjistrimeve dhe vetëm një fakultet ka shënuar ulje në krahasim vitin akademik 2012/2013.

Fakulteti	2011/2012	2012/2013	2013/2014
BE	273	290	328
SHTB	208	175	235
Drejt.	274	206	242
GJKK	207	247	247
APSHP	318	247	205
<b>Total</b>	<b>1280</b>	<b>1165</b>	<b>1257</b>

Tabela 2. Numri i përgjithshëm sipas fakulteteve

### 5.3 Kalueshmëria e studentëve

Kalueshmëria e studentëve ju referohet atyre studentëve të cilët mbasin student aktiv në programet akademike të cilët janë regjistruar. Zvogëlimi i numrit të studentëve që i ndërpresin ose tërhiqen nga studimet është indikator kryesor i suksesit në cilindo institucion të arsimit të lartë. Siç mund të shihet në tabelat 3 ose 4, UEJL bënë punë të mirë në kalueshmërinë e studentëve pasi kryejnë vitin e parë të studimeve, por, mbetet mjaftë punë për tu bërë në kalueshmërinë e numrit të studentëve në vitin e tretë.

Gjenerata 2012/13	Student të rregullt 2012/13	Kalueshmëria 2013/14		Kalueshmëria 2014/15	
		Kalueshmëria në vitin e dytë	%	Kalueshmëria në vitin e tretë	%
Fakultetet	Studentët				
B&E	141	120	85.11%	111	78.72%
SHTB	142	114	80.28%	102	71.83%
Drejtësi	156	126	80.77%	124	79.49%
GJKK	101	84	83.17%	81	80.20%
AP&SHP	158	134	84,81%	123	77.85%

Tabela 3. Kalueshmëria për gjeneratën 2011/12

Gjenerata 2012/13	Student të rregullt 2012/13	Kalueshmëria 2013/14		Kalueshmëria 2014/15	
		Kalueshmëria në vitin e dytë	%	Kalueshmëria në vitin e tretë	%
Fakultetet	Studentët				
B&E	160	139	86.88%	105	65.63%
SHTB	118	97	82.20%	78	66.10%
Drejtësi	144	128	88.89%	102	70.83%
GJKK	118	106	89.83%	92	77.97%
AP&SHP	122	107	87.70%	96	78.69%


Tabela 4. Kalueshmëria për gjeneratën 2012/13

### 5.4 Diplomimi i studentëve

Grafikoni 2 prezanton të dhënat për diplomimin e studentëve krahasuar me regjistrimin e tyre. Siç mund të vërehet ka dallim në mes numrave të studentëve regjistruar dhe të diplomuar në kohë, kjo mbetet çështje për t'u



trajtuar në të ardhmen në Universitet. Veçanërisht për gjeneratën 2011/2012, nga 698 student të ri të regjistruar, 146 studentë kanë diplomuar në kohë (të definuar sipas grumbullimit të 180 ECTS kredive për një periudhë tre vjeçare). Duhet të konstatohet se studentët mund të mos diplomojnë në kohë për dy arsye akademike dhe administrative (p.sh. pa mundësi të paguajë pagesën e shkollimit ose fatura tjera që duhet ti përmbush ndaj Universitetit).



Grafikoni 2. Shkalla e diplomimit sipas fakulteteve për gjeneratën 2011/ 2012

## 5.5 Qendra e karrierës dhe punësushmëria

Qendra e karrierës e UEJL-së paraqet burimin kryesor për studentët që realizojnë punën praktike/ internship ose kërkojnë të punësohen. Qendra e organizon Panairin e karrierës, në të cilën ngjarje kompanitë rekrutojnë/ punësojnë studentë dhe të diplomuarit e UEJL-së. Gjatë këshillimit dhe shërbimit studentëve, i këshillon ato për procesin e kërkimit të punësimit, i shpërndanë konkurset për pozitat që kërkohen dhe ofron trajnime për çështje të tilla si plotësimi i kërkesës për punë dhe të shkruarit e CV.

Shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve të UEJL-së deri në vitin 2013 është 48.97% dhe shkalla e papunëshmërisë 51.02%. Sipas të diplomuarve të punësuar 95.83% e tyre janë të punësuar me orar të plotë, 1.56 % janë të punësuar me orar të pjesshëm, 1.04% janë të vetëpunësuar (kanë biznesin e tyre), dhe 1.56% janë duke bërë internship.

Nga numri i përgjithshëm i të diplomuarve të papunësuar 21.50 % janë përgjigjur se janë të papunësuar me zgjidhjen e tyre, kështu që shkalla e papunësisë të diplomuarve të UEJL-së vlerësohet të jetë 29.52%.

Sipas punësimit në nivel të fakultetit, Fakulteti i drejtësisë ka shkallën më të lartë të papunësisë së të diplomuarve me 62.12%, i ndjekur nga Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike me 55.26%. Shkallën më të lartë të punësimit kanë të diplomuarit në Fakultetin e biznesit dhe ekonomisë me 53.17% për vitin kalendarik dhe sipas vitit akademik të diplomuarit e Fakultetit të gjuhëve, kulturave dhe komunikimit me 49.94% për vitin akademik.

Nuk ka dallime të mëdha në mes të diplomuarve me studim në gjuhën shqipe dhe gjuhën maqedonase në aspekt të papunësisë; shkalla e papunësisë të të diplomuarve me studim në gjuhën shqipe është 51.19% dhe shkalla e papunësisë të të diplomuarve me studim në gjuhën 50.57%. Nacionalitet tjera shënojnë një shkallë të papunësisë me 50 %.

Për dallim nga viti i kaluar, këtë vit të dhënat tregojnë se sa më e lartë është nota mesatare GPA (9—10), më e lartë është shkalla e punësimit (57%). Të diplomuarit me notë mesatare në mes 6 dhe 7 kanë shkallë të punësimit rreth 34.35%.

Duhet të merret parasysh se këto rezultate janë vetë raportuar në përgjigje të anketës së realizuar nga Qendra e karrierës. Metodologjia e pyetësorit nuk jep të dhëna për statusin e punësimit për ata që kanë zgjedhur të mos i përgjigjen anketës.

## 5.6 Asociacioni Alumni

Asociacioni i Alumnit të UEJL-së është definuar në Statutin e Universitetit. Është paraparë që të ruajë kontaktin me ish studentët e UEJL-së, ti përfshi ato në jetën e Universitetit dhe të merr opinionin e tyre për ekspertizën e fakulteteve veçanërisht në mbajtjen dhe zhvillimin e kutikulave të përshtatura me kërkesat e tregut të punës.

Për momentin, Asociacioni i Alumnit nuk është aktiv. Nuk ekziston sipas rregullave të parapara dhe kjo është një çështje që Universiteti duhet të trajtojë në vitin akademik 2014-2015. Për momentin nuk ka zyrtar të zgjedhur për Asociacionin Alumni.

Është inkurajues fakti se kur Universiteti organizoi takimin e Alumnit në Prishtinë dhe Shkup pjesëmarrja në këto ngjarje sociale ishte e mirë (përafërsisht 80 alumnistë në Prishtinë dhe 50 në Shkup). Kjo është një shenjë se Alumni mbetet i interesuar për institucionin dhe dëshirojnë të përfshihen në jetën e Universitetit dhe duhet të sigurohet një mundësi e mirë që UEJL të zhvillojë një mundësi më të mirë që Alumni të kontribuojë për universitetin amë (alma mater).

## 6 Hulumtimi

---

Zyra për hulumtim ofron mbështetje të drejtpërdrejtë këshillimore për hulumtime akademike dhe ndan fonde për të ofruar ndihmë për anëtarët e stafit akademik për të ndjekur interesat e tyre hulumtuese. Ky fond kryesisht ndahet për të mbuluar koston për pjesëmarrje në konferencat akademike dhe në kongrese shkencore akademike. Zyra për hulumtim gjithashtu përgjegjëse për botimin e revistës shkencore të Universitetit, SEEU Review.

Në mbështetje të hulumtimit të stafit dhe politikave promovuese, Komisioni qendror për hulumtim është takuar 11 herë dhe ka vlerësuar portofolet hulumtuese të 16 anëtarëve të ndryshëm të stafit akademik.

Pesëdhjeteshtatë kërkesa nga hulumtuesit individualë janë pranuar për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.

Zyra për hulumtime ka udhëhequr ose ka ndihmuar tri konferenca gjatë periudhës së këtij raporti: 1) “Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1913-2013) një shekull më vonë: Si ka ndryshuar gjeopolitika e Ballkanit?” më 21 nëntor 2013 në Qendrën e UEJL-së Shkup. Është përgatitur një përmbledhje e punimeve. Publikimi i librit do të jetë në janar 2015. 2) UEJL ishte nikoqir i Konferencës ekonomike rajonale me titull "Beneluxi Ballkanik" më 26 nëntor 2013 në Shkup, në Qendrën e UEJL-së Shkup, dhe 3) organizoi një konferencë ndërkombëtare shkencore me titull "Reka e Epërme dhe shqiptarët e Rekës", 14 dhjetor 2013, Mavrovë. Përmbledhja e punimeve të konferencës u publikua më 5 nëntor 2014, në Qendrën e UEJL-së Shkup.

Zyra për hulumtime ka vazhduar bashkëpunimin me Universitetin Columbia. Seminari trajnimi i trajnerëve ishte një nga aktivitetet e projektit i cili synon të transferojë kursin e trajnimit "Zgjidhja e konflikteve dhe harmonia sociale" nga Universiteti Columbia në një nga universitetet në Ballkanin Perëndimor. Për këtë qëllim, Programi i Universitetit Columbia në ndërtimin e paqes dhe të drejtave – Instituti i Universitetit Columbia për të drejtat e njeriut, së bashku me Institutin për hulumtim shkencor të UEJL-së - Max van der Stoel, organizuan seminarin trajnimi i trajnuesve për edukatorët nga rajoni nga 25-28 marsi 2013 në UEJL-Tetovë. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 20 edukatorë nga universitete të ndryshme nga i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor: UEJL, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Universiteti European i Tiranës - Shqipëri, Universiteti i Prishtinës, Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike- Shkup, Parlamenti Rinor Shqiptar - Shqipëri, dhe Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Sa i përket SEEU Review, revista ka filluar botimin e saj on line në vitin 2012 në VERSITA (e cila tani është riemëruar DE GRUYTER). Që atëherë, dy botime on line janë publikuar në vitin 2012, një në vitin 2013 (numri i dytë tashmë është ngarkuar si një botim i veçantë për mësimdhënie dhe nxënie). Vëllimi 10, botimi i parë do të publikohet edhe si një edicion special (botimi i parë 2014) në lidhje me Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

## 6.1 Instituti i hulumtimeve “Max Van der Stoel”

Ky Institut është qendra e përpjekjeve të Universitetit për të kryer hulumtime në fushën e të drejtës, shkencave politike, të drejtat e njeriut dhe të diplomacisë. MVRSRi ka për qëllim edhe të sigurojë një bazë të unifikuar për projekte hulumtimi ndërmjet shumë-fakulteteve si dhe të mundësojë UEJL që të jetë një partner i vlefshëm vendore për projektet kërkimore ndërkombëtare dhe universitetet e shquara partnere jashtë vendit.

Aktiviteti kryesor i MVDSRI për periudhën e mbuluar nga raporti ishte mbajtja e suksesshme e serisë së “Ligjëratave diplomatike.” Këto ligjëratat u mbajtën në amfiteatrin Arben Xhaferi në Tetovë, me ç’rast UEJL ishte nikoqir i disa ambasadorëve të dalluar nga komuniteti diplomatik, ligjëratat ishin për stafin

dhe studentët. Këto ligjërata ishin shumë të popullarizuara dhe kishte prezencë të mirë. Diplomatët në këto ligjërata trajtuan çështje me interes të veçantë për ta, ose ambasadat e tyre, dhe u dhanë studentëve njohuri për vlerat dhe prioritetet e komunitetit ndërkombëtar. Ndër folësit ishin ambasadori Francës, Gjermanisë, Holandës, dhe OSBE-së.

MVDSRI ishte organizator i konferencës me titull 'Sfidat bashkëkohore të multikulturalizmit dhe politika gjuhësore.' Punimet e konferencës pritet të botohen kah fundi i vitit 2014 ose në fillim të vitit 2015.

## 6.2 Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit

Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit vazhdoi të jetë kontribuesi kryesor në arritjen e qëllimeve të planveprimit klimaterik të UEJL-së. Zhvillimi kryesor i IMJSH gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport ishte transformimi i sistemit të ngrohjes me naftë në Tetovë në sistem ekologjikisht miqësor- biomasë. Kjo është parashikuar jo vetëm për të kursyer burimet dhe për të prodhuar më pak ndotje, por edhe për të kursyer paratë e Universitetit me kalimin e kohës.

Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit ishte gjithashtu është i përfshirë në marrëveshjen e bërë në mes Komunës së Tetovës dhe Universitetit të Evropës Juglindore për të prodhuar një planveprim ekologjik për komunën e Tetovës, bazuar në modelin e Planveprimit klimaterik të UEJL-së. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga rektori dhe kryetari i komunës së Tetovës.

Së fundi, UEJL ka demonstruar angazhimin e vet të vazhdueshëm për administrimin ekologjik me rinovimin e lokacionit të ri në Shkup, ku u mundësua që ndërtesa ekzistuese të ripërshtatet. Kjo ka reduktuar ndjeshëm sasinë e materialeve që do të kishin qenë të nevojshme për një ndërtesë të ngrihet nga e para.

Kodi i mjedisit të Universitetit mbetet i postuar në të gjitha klasat dhe zyrat e Universitetit. Ky ofron këshilla dhe informacion në lidhje me ruajtjen e energjisë dhe të përgjegjësisë mjedisore, në të tri gjuhët zyrtare të Universitetit.

## 6.3 Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare

Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare ka përgjegjësi për krijimin dhe mbajtjen e lidhjeve ndërkombëtare të Universitetit. Ndihej të identifikojë institucionet partnere jashtë shtetit dhe asiston në mobilitetin e studentëve që shkojnë nga UEJL dhe që vijnë në UEJL. Këto janë përpjekjet kryesore, si pjesë e *raison d'être* e institucionit që të ofrojë arsim ndërkombëtar cilësor, në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare, të bëjë diversifikimin e trupit studentor shumë gjuhësor në Tetovë dhe Shkup.

Kjo periudhë kohore e mbuluar nga ky raport ishte mjaft inkurajuese për marrëdhëniet ndërkombëtare të Universitetit. Siç u përmend në këtë raport, tre fakultete kanë bërë vlerësimin e jashtëm të programeve, të gjitha të realizuara nga ekspertë nga Universitete të dalluara nga jashtë. Dy fakultetet

e mbetura do të vazhdojnë me këtë proces gjatë vitit akademik 2014/2015. Përveç kësaj dy kampion të ri të cilësisë nga Mbretëria e Bashkuar janë angazhuar dhe kanë realizuar vizitën e parë dhe për këtë kanë dorëzuar raport.

Mobiliteti i studentëve dhe stafit është rritur gjatë periudhës së raportimit. Gjatë vitit akademik 2013/14, kishim 10 studentë që shkuan në një program mobiliteti nëpërmjet programit Erasmus dhe një anëtar i stafit nëpërmjet të njëjtit program. Përveç, kësaj fakulteti i SHTB ka dërguar disa anëtar të stafit dhe studentë në Gjøvik College në Norvegji.

Sa i përket numrit të marrëveshjeve të nënshkruara, Universiteti ka nënshkruar 29 marrëveshje gjatë vitit akademik 2013/14. Këto marrëveshje janë lidhur me universitet partnerë në kuadër të programit Erasmus+ ose protokollit Mevlana, i cili është valid për universitetet Turke.

UEJL e sheh si burim të rëndësishëm marrëdhëniet ndërkombëtare për zhvillimin në të ardhmen dhe regjistrimin e studentëve, veçanërisht për qëllimin për tu bërë partner i rëndësishëm rajonal për universitet partnerë ndërkombëtare më të vjetra.

## 7 Ndërmarrësia dhe zhvillimi

---

Fokusi kryesor i përpjekjeve për ndërmarrësi të UEJL-së është koherenca e nismave të Universitetit me komunitetin e jashtëm të biznesit. Njëherësh kjo përpjekje përqendrohet edhe në zhvillimin financiar dhe korporativ të ndërtesave në Tetovë dhe Shkup. UEJL është i pozicionuar edhe për të udhëhequr procesin e bashkëpunimit midis industrisë dhe akademisë.

Në përputhje me rrethanat, UEJL ka udhëhequr Parkun-teknologjik për më shumë se një vit, duke sjellë kompanitë vendore direkt në kampus. Ky bashkëpunim u mundëson studentëve dhe stafit të përfitojnë nga përpjekjet për ndërmarrësi nga kompanitë vendore dhe njëherësh mundëson kompanitë që të përfitojnë nga burimet njerëzore dhe materiale të Universitetit. Është qëllimi i theksuar i UEJL-së që të rritet së bashku me industrialistët, biznesmenët dhe biznesmenet aktive. Në mënyrë të ngjashme, vepron edhe programi Studimet e Integruara ku gjithashtu nxitet bashkëpunimi më i ngushtë mes biznesit dhe akademisë dhe direkt përfshin bizneset vendore në hartimin e kurrikulës dhe të vlerësimit të studentëve. Ky është një program i cili gjithashtu ofron përvojë të vlefshme dhe mundësi punësimi, për të diplomuarit suksesshëm.

Universiteti gjithashtu vazhdon të punojë korporatat dhe shoqatat e biznesit, të tilla si Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore, Shoqata Gjermane/Maqedonase, dhe Oda Amerikane e Tregtisë në Maqedoni. Përveç kësaj, Universiteti punon me komunat në të cilat ka edhe kampuset universitare dhe mban marrëdhënie të mira me komunitetet vendore dhe figurat e qeverisjes vendore.

Qendra për zhvillimin e biznesit promovon ofrimin e shërbimeve të UEJL-së si trajnime dhe konsulencë të jashtme për bizneset vendore. Përmes punës së BDC, UEJL ka ofruar modele të biznesit, trajnime të korporatave si dhe kurse gjuhësore për bizneset dhe ambasadat në Tetovë dhe Shkup. Parku-teknologjik ka organizuar seminare të shumta, duke i tubuar së bashku stafin dhe studentët e UEJL-së me sipërmarrësit, biznesmenët dhe biznesmenet vendore.

UEJL e shikon ndërtimin e lidhjeve me individë vendorë dhe kompanitë e rëndësishme për planifikimin e ardhshëm të Universitetit. Nga bashkëpunimi i mirë menduar me individët më inventivë në rajon, UEJL do të vazhdojë të ofrojë mundësi të shëndosha për partneritet akademik për korporatat dhe mundësi të punësimit për të diplomuarit tanë.

## 8 Financimi

---

Universiteti edhe këtë vit akademik vazhdon të jetë plotësisht i vetëfinancuar, pa asnjë financim nga buxheti shtetëror por me premtim të financimit në vitin 2015 me rreth 500.000€ në kundërvlerë në denarë. Proporcioni i të ardhurave për vitin akademik 2013/14 ishte si vijon: afërsisht 90% e të ardhurave janë nga pagesat e shkollimit, deri në 5% të ardhura tjera (të hyra nga aktivitetet komerciale, interesi nga depozitat dhe investimet në tregun e kapitalit, etj) dhe afërsisht deri në 5% nga projekte dhe donacione.

Sa i përket menaxhimit financiar, kanë vazhduar përpjekjet për të arritur përcaktimet strategjike të Universitetit për rruajtjen e qëndrueshmërisë financiare përmes konsolidimit të burimeve të qëndrueshme të financimit dhe eksplorimit të formave të tjera të financimit dhe diversifikimit të burimeve financiare. Këtë vit akademik menaxhmenti i Universitetit hartoi planin e zgjerimit të portfolios së investimeve duke inkorporuar këtu edhe investimin e mjeteve të lira në llogari të Universitetit në afat të shkurtë (0 - 3 muaj).

Projeksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve të Universitetit planifikohen sipas Kornizës afatmesme buxhetore në përputhje me Statutin dhe politikat e organeve më të larta të Universitetit sipas modelit RAM (Resource Allocation Model). Kjo kornizë afatmesme buxhetore 3-vjeçare e shpenzimeve siguron konsistencë të niveleve të shpenzimeve të Universitetit brenda kufizimeve të burimeve të përgjithshme, në mënyrë për të siguruar stabilitetin financiar dhe për të maksimizuar efikasitetin e shpenzimeve të përgjithshme. Parimi i pasqyrimin real, efikas dhe efektiv financiar janë fondamenti i planifikimit në UEJL. Gjithnjë e më tepër, duke i dhënë rëndësi edhe transparencës interne dhe publikimit intern dhe duke ruajtur “fshehtësitë” afariste strategjike të Universitetit.

Zhvillimi i vazhdueshëm i Enterprise Resource Planning (ERP) ka vazhduar të jetë ndër prioritetet kryesore të menaxhimit financiar dhe me qëllim të sigurimit të shërbimeve më cilësore financiare, respektim të dispozitave ligjore dhe me qëllim të operimit më efektiv përveç përditësimit të

vazhdueshëm të procedurave janë krijuar edhe standardet e shërbimeve të financave.

Pasi qëndrueshmëria financiare e Universitetit është një nga brengat kryesore të Bordit të Universitetit dhe stafit, është sugjeruar ristrukturimi i departamentit të financave (rekomandim gjithashtu i auditit të jashtëm); procesi i rishikimit të strukturës së departamentit dhe procedurave që implementohen në po këtë zyrë janë në proces.

## 9 Mjedisi dhe shërbimet në kampus

---

### 9.1 Përkrahja studentore

Përkrahja e studentëve, është realizuar kryesisht nëpërmjet Shërbimit studentor dhe Zyrës për ndihmë financiare. Studentët për vitin akademik 2013/2014, janë përkrahur financiarisht nëpërmjet programit të bursave të universitetit, granteve të donatorëve të bursave, programit “Punë dhe studime”, si dhe programit financiar-zbritje për studentin e dytë dhe të tretë të familjes. Në total, rreth 20% të studentëve të rregullt në studimet deridiplomike financiarisht janë përkrahur në një farë mase.

Programi i bursave përbëhet nga dy grupe: bursat meritore të universitetit në bazë të rezultateve të treguara nga vlerësimi paraprak i diturive dhe bursat në bazë të nevojës financiare, në bashkëpunim me Fondacionin për Shoqëri të Hapur. Në nivel të Universitetit 269 bursa janë dhënë, d.m.th 169 bursa meritore dhe 100 në bazë të nevojës financiare, që do të thotë se rreth 11% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt janë përkrahur me bursa që mbulojnë pjesërisht apo gjithë tarifën e shkollimit në programin e studimit përkatës.

Nga pikëpamja financiare, rreth 4% e studentëve të rregullt janë përkrahur nëpërmjet programit “Punë dhe studime”. Përmes këtij programi, studentët u angazhuan në shërbimet e ndryshme të universitetit duke përfituar nga përvoja relevante nga edhe realizojnë mjete financiare për të mbuluar një pjesë të tarifës së shkollimit të tyre. Në këtë vit akademik, 91 studentë ishin të angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetje të familjeve që kanë më shumë se një student që studion në UEJL është bërë zbritje e pagesës së shkollimit për studentin e dytë ose të tretë nga e njëjta familje. Nëpërmjet këtij programi të Universitetit janë mbështetur 118 studentë, çka përfaqëson 5% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt.

Vëmendje e veçantë i është dhënë zhvillimit të qasjes efektive për studentët me nevoja të veçanta dhe mundësitë për bursa për këtë grup të studentëve. Universiteti është një nga kampuset me qasje më të favorshme në vend dhe rajon për studentët me nevoja të veçanta.

Në vitin e ri akademik 2014-2015, Universiteti synon të iniciojë bashkëpunimin me sektorin bankar që të ofrojë një skemë të kredive

studentore. Kjo do të shërbejë si një instrument shtesë për mbështetjen e studentëve dhe do të ndihmojë të mbajë lidhje të forta me kompanitë që duan të përkrahin studentët e UEJL-së me bursa.

## 9.2 Ngrehinat dhe kapacitetet teknike

Kampusi i UEJL vazhdon të jetë lider në vend dhe më gjerë për nga hapësirat që i ka në dispozicion si dhe mënyrën se si mirëmbahen ata. Këtë më së miri e tregojnë vlerësimet on line të bëra nga studentët dhe stafi që janë shumë të larta. Në shkallën pre 1 deri në 5 ata shënojnë 4.1 që është fryt i angazhimit i të gjithë të punësuarve në Universitet, e posaçërisht i departamentit të mirëmbajtjes dhe logjistikës.

Hapësirat e Universitetit dhe pajisjet përcjellëse të tyre gjithmonë mirëmbahen që të kenë një pamje të mirë, por edhe ta ruajnë funksionin e tyre themelor që ata e kanë.

Harxhimet në departament me sukses evidentohen dhe analizohen me të vetmin synim që ata sa më shumë të reduktohen. Është më rëndësi për këtë rast të përmendet kursimi i naftës i cili në këtë periudhë është evident, por edhe harxhimet tjera janë zvogëluar për 12 % në krahasim me periudhën e kaluar. Mënyra e punës karakterizohet me përfshirjen aktive në zbatimin e procedurave të bazuara në standardet ISO si dhe synimin permanent për të përmirësuar cilësinë. Kjo arrihet edhe duke përcaktuar në mënyrë sa më të saktë përgjegjësit dhe autorizimet për të gjithë të punësuarit.

Duke planifikuar me kohë, gjatë periudhës së verës janë bërë shumë riparime nëpër objekte, konkretisht janë eliminuar të gjitha plasaritjet nëpër klasa si dhe janë ngjyrosur të gjitha klasat që ato të mbahen në kondicion dhe të japin një pamje më të mirë. Jo vetëm klasat brenda, por edhe pamja e jashtme të jep përshtypje se mirëmbajtja është e nivelit të lartë dhe me një planifikim preciz. Në pamjen e jashtme vlen të përmendet rregullimi i sinjalistikës dhe vendosja e shenjave të rejave aty ku ka pasur nevojë.

Duke dashur që të jetë në vijën e eko-kampusit, gjatë verës është zëvendësuar sistemi i vjetër i nxehjes me naftë me sistem të ri me pelte, gjë që do të ulë kostot më tepër se 50 %, por edhe do ta zvogëlojë dukshëm emetimin e gazit CO<sub>2</sub>. Vetëm për këtë investim Universiteti ka ndarë afër 500 mijë euro të cilat pritet që t'i kthehen në vitet në vijim. Janë vendosur reflektorë me teknologjinë më të re "led" të cilët në vendet më pak të frekuentuara ndizen në lëvizje me çka zvogëlohet harxhimi i energjisë elektrike.

Në vitin e ardhshëm akademik departamenti i Mirëmbajtjes dhe logjistikës do të integrohet në sistemin ekzistues të elektronizimit të proceseve, për të siguruar optimizmin e kostos me një kontroll shumë fleksibile.

## 9.3 Qendra e UEJL-së në Shkup

Periudha e mbuluar nga ky raport ishte viti i gjashtë që Universiteti i EJL është i pranishëm në Shkup si dhe në viti i parë në mjedisin e ri. Që nga tetori 2013



kampusi i UEJL-së në Shkup është vendosur në një ndërtesë të rinovuar dhe moderne me një sipërfaqe prej 2.400 m<sup>2</sup>, në qendër të kryeqytetit. UEJL ka ndërmarrë një investim të madh në përshtatjen e objektit në një qendër moderne arsimore me të gjitha elementet e një kampusi universitar.

Kampusi i UEJL Shkup tani përbëhet nga 14 klasa për ligjërime (të pajisura me pajisje projektimi dhe pajisje për regjistrimin e prezencës), dy laboratorë kompjuterike (me Smart Boards), një amfiteatër me 170 ulëse dhe dy kabina përkthimi, këndi i administratës me tri zyra dhe Info Deskun funksional, sallë takimi për 16 persona të pajisur me pajisje për videokonferencë, një kafiteri dhe degën e bibliotekës me sallë leximi.

Kampusi i UEJL në Shkup operon me një strukturë të riorganizuar të administratës në mënyrë që t'i shërbejë një numri më të madh të studentëve dhe për të mirëmbajtur hapësirat dukshëm më të mëdha. Ne kemi vazhduar të ofrojmë shërbimin e pastrimit, mirëmbajtjes dhe shërbimin e sigurimit me ofertues të jashtëm 24/7. Administrata është e përbërë nga një total prej katër punëtorëve administrativë, një bibliotekare dhe drejtori. Shtrirja dhe përgjegjësia e këtyre pozicioneve është zgjeruar, në mënyrë që të reflektojë numrin më të madh të studentëve që ndjekin studimet në UEJL Shkup krahasuar me vitet e mëparshme dhe për të përmirësuar shërbimet në dispozicion të studentëve dhe palëve të interesuara të jashtëm.

Ambientet e reja kërkonin një sistem kompleks të instalimeve (ajër të kondicionuar, ngrohje dhe ftohje, instalim elektrik dhe rrjet, sisteme të sigurisë). Të gjitha këto duhej verifikuar, testuar dhe në disa raste të jenë përfunduar ose riparuar për shkak të aktivizimit të fundit. Të gjitha lidhjet në klasë duhej të kompletohen me instalime elektrike dhe sisteme të mbrojtjes me arritje të fjalës së fundit dhe në disa raste pajisje shtesë për projektim dhe këto janë blerë në mënyrë që të kompletohen instalimet. Premisat për video konferenca tani janë të shkëlqyera dhe duhet të përdoren në mënyrë më aktive për të nxitur integrimin ndërmjet Tetovës dhe Shkupit.

Duke konfirmuar ambiciet e universitetit për zgjerimin e operacioneve në Shkup, në ambientet e reja, regjistrimi i studentëve të rinj në periudhën e këtij raporti tregoi një rritje rreth 30% në numrin e studentëve të rinj, në krahasim me vitin e kaluar. Oferta akademike ishte e ngjashme me vitet e mëparshme. Ambientet e reja kanë tërhequr interesin më të lartë në mesin e qytetarëve të Maqedonisë dhe studentëve të interesuar nga jashtë. Megjithatë, rekomandohet që oferta e lëndëve zgjedhore dhe zgjedhore të lira duhet të rishikohet dhe të pasurohet për kampusin Shkup, për shkak të rritjes së numrit të studentëve dhe nevojës për të bërë ofertën e tyre akademike të barabartë me atë në dispozicion në Tetovë.

Një shumëllojshmëri e ngjarjeve janë organizuar gjatë vitit akademik 2013/14 në kampusin e UEJL-së Shkup, kryesisht në amfiteatër. Përfshi disa konferenca akademike, si dhe takime të marrëdhënive me publikun të organizuara nga Universiteti.

Kampusi UEJL-së Shkup është duke u bërë një vend i njohur për ngjarjet që sjellin së bashku akademinë, biznesin dhe aktorët tjerë relevantë në shoqëri.

Kampusi i UEJL-së në Shkup kontribuon jo vetëm për kapacitetet infrastrukturore të universitetit për ofertat tona akademike, por gjithashtu paraqet një pikë të rëndësishme dhe shërben si një iniciator i ndryshimeve të orientuara në drejtim të funksionimit më të mirë të Universitetit në tërësi.

## 9.4 Burimet njerëzore

Ne përputhje me rekomandimet e Komitetit të Stafit dhe të politikave të Bordit, Universiteti edhe këtë vit ka vazhduar me implementimin e Strategjisë zhvillimore të Universitetit në domenin e burimeve njerëzore e cila në vete ngërthen një sërë aktivitete të cilat përfshijnë identifikimin e burimeve njerëzore adekuate në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit, rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ, trajnimin dhe zhvillimin e stafit të inkuadruar në akademi, udhëheqjen dhe administratën si dhe planifikimin e zëvendësimit të stafit i cili pensionohet.

Universiteti edhe këtë vit ka vazhduar me sukses me udhëheqjen dhe procesimin e promovimit të stafit akademik në tituj mësimor-shkencor dhe mësimor-profesional konform detyrimeve ligjore dhe rregulloreve. Nëntë anëtarë të stafit akademik janë avancuar në tituj mësimor-shkencor, kurse 13 janë avancuar në tituj mësimorë- profesionalë.

Të dhënat në vazhdim japin pasqyrim për procesin e promovimit stafit akademik në thirrje mësimor-shkencore për tre vjetët e fundit. Ne vazhdim tabela me të dhënat për titujt shkencorë për stafin akademik për tre vjetët e fundit:

Titulli shkencor	Viti akademik 2011 / 2012	2012 / 2013	2013 / 2014
PhD	72	86	72
MA	64	52	40
BA	4	1	1

Tabela 5. Staf akademik në thirrje mësimor-shkencore për tre vjetët e fundit

Gjatë vitit akademik 2013/2014 është analizuar dhe monitoruar edhe rregullshmëria dhe produktiviteti i punës së administratës së universitetit me qëllimin e vetëm që të arrihet me sa ma pak staf të angazhuar punë e suksesshme dhe në kohë për të qenë në shërbim të stafit akademik dhe të studentëve ku rëndësi e veçantë i është kushtuar procesit të rekrutimit të stafit administrativ me kuadro përkatëse nga jashtë universiteti vetëm në rastet kur është konstatuar se ato kuadro nuk mund të sigurohen me konkurse të brendshme.

Anëtarë të stafit administrativ gjithashtu kanë vazhduar kualifikimin e tyre në grada shkencore. Në vazhdim të dhënat – kualifikimi për tre vjetët e fundit për stafin administrativ ne marrëdhënie të rregullt pune:

Titulli shkencor	Viti akademik 2011 / 2012	2012 / 2013	2013 / 2014
PhD	5	5	2
MA	15	15	16
BA	75	73	62

Tabela 6. Staf i administrativ ne marrëdhënie të rregullt pune

Është përgatitur dhe është vënë në përdorim WEB faqja e veçantë e zyrës e cila edhe plotësohet dhe përditësohet me informata ne vazhdimësi. Është vazhduar me sukses implementimi dhe raportimi i hyrje-daljeve me leje qarkullimi nga kampusi gjë që dukshëm e ka përmirësuar prezencën dhe respektimin e kohës së punës.

## 9.5 Sistemet e informacionit

Gjatë vitit akademik 2013/2014, Universiteti plotësisht ka testuar zgjidhjet elektronike të zhvilluara rishtazi për regjistrimin dhe ndjekjen e prezencës së studentëve në ligjërata dhe klasa. Gjatë kësaj periudhe janë gjetur probleme të ndryshme, pastaj janë lokalizuar dhe janë zgjidhur ato. Sistemi aktualisht është përmirësuar mjaft dhe stafi akademik është në gjendje që të kontrollojë prezencën e të punësuarve dhe të studentëve në kohë reale. Në këtë drejtim, gjithashtu është e rëndësishme të përmendet se mënyra e lëshimit të kartave të studentëve RFID është ndryshuar dhe është përmirësuar.

Një auditim i sigurimit të jashtëm për të dhënat personale është kryer dhe bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi, një zgjidhje për aktivitetet regjistrimit dhe përpunimit të dhënave personale është zhvilluar. Pjesë e kësaj zgjidhje është përdorimi i instrumentit të raportimit i cili do të lejojë auditorët e sigurisë të jashtëm në të ardhmen për të dhënat personale që të kenë një pasqyrë në proceset e institucionit. UEJL është i përkushtuar që të respektojë të dhënat personale dhe të jetë plotësisht në pajtim me kërkesat e ligjit për të dhënat personale.

Për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të unifikuar të mesazheve, është zhvilluar një modul për menaxhimin dhe sinkronizimin e anëtarësisë në grupe dinamike postare. Grupet e e-mailit përcaktohen bazuar në kritere të tilla si koha, vendndodhja, semestri, viti i studimit, ose fakulteti (për studentët) dhe stafi akademik, administrata, me orar të plotë, me kohë të pjesshme (për të punësuarit). Kjo ka mundësuar njoftimin më të efektshëm, si dhe shpërndarjen më efektive të informacionit, për studentët dhe të punësuarit.

Procesi i diplomimit të studentëve është elektronizuar dhe është automatizuar për të minimizuar hapat formalë të përpunimit të diplomave të studentëve, pasi ata kanë përmbytur të gjitha detyrimet e tyre akademike. Ndërfaqja e këtij moduli është integruar në MySEEU për studentët dhe në SharePoint për administratën. Ndërfaqja për studentët gjithashtu përfshin një përmbledhje grafike të procesit, në mënyrë për t'u mundësuar atyre për të ndjekur ecurinë e kërkesës së tyre.

Një numër i përmirësimeve të tjera është bërë në sistemet ekzistuese elektronike të regjistrimit të meritës. Dukshëm në këtë kontekst ishin krijimi i një moduli për gjenerimin automatik të raporteve të tatimit mbi të ardhurat për të punësuarit; ndryshime dhe përmirësime në modulin MyResearch në bazë të kërkesave nga KQH dhe përdoruesit; ndryshimet dhe korrigjimet në lëshimin e transkripteve në mënyrë që të filtrohen ato edhe sipas mënyrës së studimit dhe ciklit të studimit; dhe me një buton të vetëm të ketë qasje (SSO) mundësi që i lejon përdoruesit të identifikohet një herë dhe të ketë qasje në të gjitha burimet relevante elektronike.

Vlen të theksohet se e gjithë infrastruktura e TI është transferuar me sukses në lokacionin e ri në Shkup dhe, në të njëjtën kohë, kapacitetet janë zgjeruar duke krijuar një dhomë të dytë për serverët. Kjo dhomë e re për serverët në degën e Shkupit do ta minimizojë ndikimin e ndërprerjeve të lidhjes së internetit në mes Tetovës dhe Shkupit.

Këto përmirësime të realizuara nga Departamenti TI kanë dëshmuar përkushtimin e Universitetit tonë që të vazhdojë të jetë në mesin e udhëheqësve në implementimin e teknologjisë më të fundit nga fusha TI.

## 9.6 Biblioteka

Biblioteka universitare "Max van der Stoel" funksionon dhe u ofron shërbimet e veta studentëve dhe stafit akademik në formë të librave, revistave shkencore dhe databazave Ebsco dhe Ekon-Biz në kampusin Tetovë dhe Shkup.

Shërbimet janë profesionale dhe të nivelit të lartë, efikase dhe produktive që nuk lejojnë pritje për marrjen e materialit të duhur. Gjatë gjithë vitit akademik ushtron fushatë permanente si dhe trajnim të studentëve dhe të stafit për përdorimin e databazave dhe ofrimin e risive të blera. Blerja, freskimi i fondit të librave është prioritet i bibliotekës, përpunimi i materialeve të blera është efikas dhe bëhet sipas standardeve ndërkombëtare të bibliotekarisë, klasifikimi dhe katalogizimi decimal ndërkombëtar. Mirëmbajtja e bibliotekës bëhet në mënyrë korrekte përfshi dy sallat e leximit, ku përveç tjerash këtu ofrohen dhe realizohen edhe mbrojtje të doktoratës dhe tezave të magistraturës.

Stafi i bibliotekës është profesional dhe i kualifikuar për veprimtari bibliotekare dhe me sukses e ushtron këtë veprimtari. Gjithashtu me sukses e inkuadron edhe stafin ndihmës së studentëve të angazhuar në kuadër të programit "Punë dhe studime", të cilët janë ndihmesë e rëndësishme në punët e bibliotekës.

Gjatë vitit të kaluar, është realizuar edhe një bashkëpunim i suksesshëm me Bibliotekën universitare kombëtare të Shkupit e cila na ofron huazimin e materialeve që ne nuk i posedojmë.

## 9.7 Parlamenti i studentëve

Në këtë vit akademik Parlamenti i studentëve u konsolidua në funksionimin e tij me formatin e ri. Parlamenti përkrahi formimin e klubeve të ndryshme të cilat në fokus patën zhvillimin e aktiviteteve të studentëve në lëmenjtë e ndryshëm. Për të realizuar planet e tyre të veprimit të gjitha klubet u përkrahën me një buxhet modest. Të gjitha këto klube organizuan së paku nga një ngjarje me kyçjen e studentëve të të gjitha fakulteteve dhe cikleve. Këtu vlen të ceket se edhe studentët në kampusin e Shkupit janë shumë të interesuar të marrin pjesë të barabartë në punën e Parlamentit Studentor.

Gjithashtu, Parlamenti Studentor aktivisht ka përkrahur Universitetin në organizimin e evenimenteve të ndryshme si dita e Universitetit, dita e hapur, dita e diplomimit si dhe tjera manifestime të studentëve.

Si çështje për të përmirësuar në të ardhmen ngel animimi i të gjitha klubeve për organizimin e më shumë evenimenteve, por edhe ndarja më e baraspeshuar e buxhetit mes klubeve. Momentalisht një pjesë e konsiderueshme e buxhetit përdoret për vizita të natyrës edukative, kulturore si dhe për koncerte nga artistë të shquar të estradës vendore, por edhe ndërkombëtare.

## 9.8 Sporti dhe rekreacioni

Në mënyrë që t'i promovojë aktivitetet sportive në Universitetin, Departamenti i Sportit (një njësi e pavarur brenda UEJL-së), si vitin e kaluar ashtu edhe këtë vit zhvilloi një anketim në mënyrë që të përcaktojë se cilat sporte i tërheqin më shumë studentët.

Për këtë vit mund të potencohet se janë bërë përmirësime të dukshme në infrastrukturën e objekteve sportive në kampus, veprim i cili rezultoi shumë i qëlluar, pasi u bë adaptimi i ndërtesës 818, për përfshirjen pajisjeve për gjimnastikë, blerja e mjeteve për fitnesit, rinovimi i fushave (tenis, basketboll, volejboll), dhe përforcim i ndriçimit në terrenet. Këto rezultate të kombinuara kanë dhënë një rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete sportive.

Edhe këtë vit akademik, në fund të semestrave (vjeshtor dhe pranveror), janë organizuar gara në futboll të vogël, basketboll, tenis, shah dhe ping-pong. Si vitin e kaluar akademik, ashtu edhe këtë vit, gjatë aktiviteteve të "Ditës së hapur" të UEJL-së, është organizuar garë në futboll të vogël për nxënësit e shkollave të mesme të Tetovës me pjesëmarrje të të gjitha shkollave nga rajoni.

Departamenti i Sportit, në kuadër të universitetit ka qenë aktiv edhe në kampionatin universitar që organizohet nga Federata sportive universitare e R. Maqedonisë, edhe atë me disa ekipe si ai i futsallit, ping-pongut dhe shahut. Në nivel shtetëror, ekipi i futsallit vazhdon pjesëmarrjen në Kampionatin republikan me sukses të dalluar. Janë bërë hapat e para në zhvillimin e interesit të studentëve dhe të punësuarve në çiklizmin rekreativ, janë pajisur uniforma (forma) speciale për biçiklizëm. Në këtë aktivitet,

studentët edhe stafi bëjnë çiklizëm në shtigje të ndryshme në rajonin e Tetovës. Aktivitet tjetër sportiv që vlen të përmendet është alpinizmi dhe skitaria; UEJL këtë vit është plasuar në vendin e II në garat e 7-te ndëruniversitare në Kodrën e Diellit, ku vlen të potencohet se edhe këtë vit si organizator teknik ishte UEJL dhe organizimi nga ana e delegatëve u vlerësua me një notë shumë të lartë.

Këtë vit akademik janë organizuar shumë aktivitete sportive edhe me studentët e Shkupit.

Në ndërtesën e UEJL-së është vendosur një tabëll e ping-pong-ut, disa garnitura të shahut dhe bëhet komunikim më të shpeshtë për inkuadrimin e drejtpërdrejtë në turnamentet dhe aktivitetet sportive që i organizojmë në Tetovë.

## 10 Konkluzionet

---

Universiteti i Evropës Juglindore mbetet i përkushtuar për etikën primare të themelimit, të ofrojë arsim të një cilësie ndërkombëtare për studentët e rajonit, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjuha amtare, feja, vendi i origjinës apo gjinia. Universiteti ruan politikën e "përdorimit fleksibil të gjuhëve" ku të tri gjuhët zyrtare në nivel të Universitetit, ku gjuha shqipe, angleze dhe maqedonase përdoren në klasa dhe në korrespondencën zyrtare, njoftimet, dhe ceremonitë. Universiteti ndan jep diploma në të tri ciklet e studimit dhe është në përputhje me tendencat kryesore të arsimit të lartë evropian.

Këto janë kohë të vështira për institucionet e arsimit të lartë, në të gjithë botën dhe UEJL përballet me sfidat dhe këtë e pranon hapur. Rritja e konkurrencës nëpërmjet dispersimit të universiteteve shtetërore ka pasur një ndikim negativ në rekrutimin e studentëve. Pagesat tona për studim mbetën të larta në nivel rajoni, veçanërisht në krahasim me nivelet e ulëta të pagesave për studim në universitetet shtetërore. Grantet ndërkombëtare dhe fondet për hulumtim janë të vështirë për t'i fituar dhe konkurrenca për pjesëmarrje në këto mundësi është e lartë. Emigracioni dhe tendencat demografike në Republikën e Maqedonisë kanë zvogëluar madhësinë e numrit të mundshëm të studentëve. Këto do të jenë sfidat e universitetit për t'u përballuar dhe për të kapërcyer në vitet në vijim.

Ky raport bën rekomandime të shumta individuale në seksione të veçanta. Në vijim janë zotimet më të përgjithshme të Universitetit dhe për shumicën e të cilave pajtohet personeli akademik dhe administrativ:

- për rritur numrin e studentëve në ciklin e parë dhe dytë;
- të bëhen përpjekje më të mira për mbështetje të hulumtimit për studentët në studimet pasdiplomike dhe stafin;
- të përmirësohet bashkëpunimi me bizneset vendore dhe ndërmarrësit;
- të vazhdohet me planveprimin klimaterik dhe iniciativat tjera miqësore për mjedisin;
- të përmirësohet përkrahja studentore dhe përgjigjja e stafit ndaj kërkesave dhe ankesave të stafit;
- të rritet përbindja e studentëve që diplomojnë në kohë.

Pavarësisht nga sfidat me të cilat përballemi dhe në të vërtetë të gjitha, universitetet moderne, UEJL mbetet një vend vital i dijes dhe arsimit. Ai siguron mësimdhënie cilësore për çka ka fituar respektin e komunitetit dhe kjo përbën një angazhim ndaj tolerancës dhe barazisë. Universiteti vazhdon të tërheqë studentë të rinj në të gjitha tre nivelet dhe është një partner i vlefshëm për komunat, bizneset, dhe universitetet e huaja partnere.

UEJL mbetet i përkushtuar ndaj idealeve për të cilat u themelua: për të siguruar arsimim cilësor pavarësisht gjuhës, përkatësisë etnike, fesë, apo

gjinisë. Universiteti mbetet i bindur se angazhimi i këtyre idealeve është çelësi për suksesin e ardhshëm dhe ofrues i vazhdueshëm i mundësive të shkëlqyera arsimore.

#### Anëtarët e komisionit të vetë-vlerësimit

- Provosti
- Sekretari i përgjithshëm
- Këshilltarja ekzekutive për cilësi
- Përgjegjësi i Qendrës së UEJL-së Shkup
- Drejtori i Shërbimeve studentore
- Përfaqësues të të gjithë pesë fakulteteve
- Drejtori i Qendrës së gjuhëve
- Drejtori i Qendrës për eMësim
- Asistenti për sigurimin e cilësisë, përkrahje teknike